Ambulatorium
Sonnenschein
Sozialpädiatrisches Zentrum

INFORMACION PËR PRINDËRIT!

Të nderuar prindër dhe të afërm!

Ne gëzohemi që të punojmë së bashku me ju dhe fëmijën tuaj.
Që kjo marrëdhënie të funksionojë mirë duam t'ju informojmë për sa më poshtë.

1) Rekomandimi i mjekut dhe raporti i mjekut kryesor

Të gjitha programet e terapisë kryhen sipas udhëzimeve nga mjeku juaj. Prandaj na nevojitet letrat e rekomandimit nga mjeku kryesor i sigurimeve shoqërore të njërës prej kompanive të mëposhtme: SVB, SVG dhe KFA.

Ju lutemi vini re: Një ndryshim në detajet e kontaktit tuaj (emrin, adresën , numrin e telefonit,
dhe sigurimet shoqërore) duhet të raportohet në sekretari.

2) Kontrolli mjekësor

Zhvillimi i kontrollit diagnostikues është i nevojshëm për planifikimin të trajtimit dhe ju jep komente për ecurinë e zhvillimit të fëmijës tuaj.
Prandaj kontrollet mjekësore kryhen në fillim dhe gjatë kursit të trajtimit që do të përcaktohet në marrëveshje me mjekun në kohën e duhur.

Ju lutemi vini re: Kontrolli mjekësor në kohën e rënë dakord është parakusht për ecurinë e terapisë. Nëse deri një muaj pas datës së përcaktuar, nuk na **telefononi** (bazuar në atë që është rënë dakord) **ose për të caktuar një takim të mëtejshëm**, ne do të supozojmë se vajza juaj / djali juaj nuk kanë nevojë për terapi në klinikë, ndaj do të hiqen nga lista e pritjes.

<u>Për familjet, gjuha amtare e të cilave nuk është gjermanishtja:</u>

Në mënyrë që ne të mund të kuptojmë shqetësimet tuaja në lidhje me fëmijën tuaj, e kur nuk keni njohuri të pakta të gjuhës gjermane **ne do t'ju ofrojmë një përkthyes!**

3) Seancat e terapisë

Një seancë terapie zgjat 50 minuta. Nëse nuk qëndroni në klinikë gjatë trajtimit, jeni të detyruar ta merrni fëmijën tuaj në kohë.

<u>Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për fëmijën tuaj mbas kohës së terapisë.</u>

4) Anullimi i terapisë

Në mënyrë që të mos humbasë një seancë terapie ose një takim vijues me mjekun, ne ju kërkojmë që të njoftoni një anulim sa më parë që të jetë e mundur, por jo vonë se 24 orë përpara takimit (me telefon, me email/faks ose personalisht në zyrë).
Kjo do të na mundësojë që takimin t'jua ofrojmë pacientëve të tjerë.
Sekretarinë tonë mund ta kontaktoni me telefon nga e hëna deri të premten nga ore 08.00 deri 12.00 dhe nga ora 13.00 deri 17.00.

Në takimet e caktuara në bllok, anulimet nga ana e pacientit nuk mund të zëvendësohen me një takim tjetër. Por takimet e anuluara nga ana jonë (p.sh. për shkak të një sëmundjeje të papritur të teraptistit/es) do të zëvendësohen. Në rast të tillë do të njoftoheni me tekst ose me telefon që takimi është anuluar.

Nga një pikëpamje mjekësore dhe ekonomike vazhdimësia e kujdesit është parakusht për terapi të suksesshme, ndaj ne dëshirojmë të theksojmë sa më poshtë:

5) Mungesat e pajustifikuara:

Ju lutemi vini re: Në Klinikën Sonnenschein shumë fëmijë dhe të rinj presin një mundësi për terapi. Mosanulimi në kohë do të thotë jo vetëm humbje e terapisë për fëmijën tuaj, por humbje e kohës së vlefshme për terapi për të tjerët!

Nëse vajza apo djali juaj nuk paraqiten në 2 seanca terapie të rëna dakord brenda 3 muajve kalendarikë pa anulim paraprak, ju do të merrni njoftim në lidhje me humbjen e pashmangshme të seancave të terapisë në të ardhmen.

Nëse ka një mungesë tjetër të pajustifikuar në seancën e terapisë, ne nuk do t'i ofrojmë fëmijës tuaj seancë terapie për një periudhë prej 9 muajsh.

6) Rezultatet

Ju do të merrni një kopje të rezultateve të vizitës së parë (asaj mjekësore dhe vlerësimit diagnostikues psikologjik) për përdorim personal. Rezultatet e tjera do të dërgohen te mjeku që do të vazhdojë kontrollin ose mund të merren nga klinika e pacientëve ambulatorë sipas kostos përkatëse (shikoni njoftimin te dhoma e pritjes).

Për kërkesat, ankesat ose sugjerimet tuaja të biznesit personeli administrativ dhe/ose mjekësor është në dispozicionin tuaj.

Ju falënderojmë për interesin tuaj!

Unë e kam lexuar këtë informacion dhe jam dakord me përmbajtjen.

……..……

Nënshkrimi (Personi përgjegjës/kujdestari)